



SHQIPËRIA

në rrugën e saj evropiane

#BEzgjjerimi



Etapat kyçe

PRILL 2009

Aplikimi për anëtarësim në BE

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit

QERSHOR 2014

Dhënia e statusit të vendit kandidat në BE

PRILL 2018

Komisioni rekomandon hapjen e negociatave të anëtarësimit

QERSHOR 2018

Këshilli përcakton rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit

MARS 2020

Këshilli vendos të hapë negociatat e anëtarësimit dhe miraton vendimin e tij

KORRIK 2020

Prezantimi i draft kornizës së negociimit Shteteve Anëtare

KORRIK 2022

Konferenca Ndërqeveritare mbi negociatat e anëtarësimit

Nisja e procesit të shqyrtimit analitik




Tregtia dhe investimet

- BE-ja është partneri më i madh tregtar i Shqipërisë
- Investimet e Huaja Direkte të BE-së në Shqipëri arritën në 610.9 milionë euro në vitin 2021
- Vëllimi i tregtisë së mallrave me BE-në ishte 5.9 miliardë euro në vitin 2021



Financimet e BE-së

- BE-ja është ofruesi më i madh i ndihmës financiare për Shqipërinë
- BE-ja mbështet zhvillimin socio-ekonomik dhe reformat në rajonin e zgjerimit, duke përfshirë Shqipërinë, me asistencë financiare dhe teknike nëpërmjet **Instrumentit për Asistencë Para-Anëtarësimit (IPA)**
- Për periudhën 2021-2027, fondet IPA III për gjithë rajonin e zgjerimit janë **14.162 miliardë euro***. Ato u korrespondojnë përparësive tematike.



*Asistenca IPA bazohet më tepër te përparësitë tematike të BE-së se sa te atokimet e paracaktuara të vendeve, rrjedhimisht edhe shuma globale për rajonin e zgjerimit.



Plani Ekonomik dhe i Investimeve

Gjatë shtatë viteve të ardhshme, BE-ja do të mobilizojë deri në **30 miliardë euro** në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare, përmes Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor të nisur në vitin 2020. Projektet e mëposhtme të Planit për Shqipërinë u miratuan në vitin 2022:

- **Transport i qëndrueshëm:** bypass-i i Tiranës, linja hekurudhore e Hanit të Hotit
- **Energjia e pastër:** Termocentrali fotovoltaiq diellor lundruës i Vaut të Dejës

- Plani Vjetor i Veprimit 2021 për Shqipërinë parasheh një buxhet prej **64.9 milionë eurosh** për mbështetje të masave në drejtësi, të drejtat e pronës, ekonominë rrethore dhe rritjen e gjelbër, inovacionin dhe natyrën.
- Për vitet 2014 - 2020 fondet IPA II të përcaktuara për Shqipërinë arritën në **758 milionë euro**.
- 569 milionë euro kredi të Bankës Evropiane të Investimeve që nga viti 1999
- **115 milionë euro** grante të BE-së për rehabilitim dhe rindërtim pas tërmetit të vitit 2019.



Kapitali njerëzor dhe inovacioni

- BE-ja i kushton vëmendje të veçantë rinisë, arsimit dhe inovacionit dhe po e ndihmon Ballkanin Perëndimor të zbatojë skemat e Garancisë për Rininë për të mbështetur punësimin e të rinjve
- Mbi 9.800 pjesëmarrës nga Shqipëria në shkëmbimet studentore, akademike dhe rinore në kuadër të ERASMUS+ (2014-2020)
- 25 milionë euro në mbështetje të shoqërisë civile (2014-2020)

Përditësimi i fundit: 10/2022